

Dalës-Izlazno

Nr. 1-63
Br.

Data 22.04.2021
Datum

OBILO-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI⁴⁸, mbledhja e 4) me dt. 30.04.2021 (e premtë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Projekt Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës
4. Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK, Bakshi
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.23.03.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumljia (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, drejtorët komunal, Sherif Hoti, menaxher i Prokurimit, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, dhe përf. i IZHL-së
Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara:
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës Janar – Dhjetor 2020
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kastrioti" SH.A.
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq
6. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit
7. Kërkesat nga MPL, për rishqyrtim të vendimeve të Kuvendit komunal të dt. 29.01.2021 dhe atë:
 - a) Vendimi nr. – I - 09
 - b) Vendimi nr. – I - 10
 - c) Vendimi nr. – I - 11
 - d) Vendimi nr. – I - 12
 - e) Vendimi nr. – I - 13
 - f) Vendimi nr. – I - 14
 - g) Vendimi nr. – I - 15
 - h) Vendimi nr. – I - 16
 - i) Vendimi nr. – I - 17
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi –I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Lulzim Sadiku – Propozoj që pika e 3 e rendit të ditës, raporti i Kryetarit të Komunës, të hiqet nga rendi i ditës meqenëse, Kryetari nuk është prezentë në mbledhje dhe nuk është e drejtë dikush tjetër me na dhënë përgjegje neve, sepse quhet raporti i Kryetarit të Komunës.

Kryesuesi – Kryetari nuk është prezentë sot, por është Nënkryetari dhe drejtorët komunal, të cilët mund të përgjegjen. Ky raport nuk votohet, është publik dhe ju mund ti jepni vërejtjet e juaja. Anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për e miratuan rendin e ditës të cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Nora Preniqi me arsye

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi –Paraqet raportin e punës të Kryetarit të Komunës, Janar – Dhjetor 2020.

Lulzim Sadiku –Unë vërtetë kërkova që të jetë prezentë Kryetari sepse quhet raporti i Kryetarit dhe nuk është Nënkryetari apo drejtorët ata që e mbrojnë, por është shumë më e drejtë që të jetë prezentë sepse është një raport i një Kryetari i cili e udhëheqë Komunën. Mendoj se ky raport ka shumë të meta sikurse në raportimet e tij në të kaluarën edhe këtë herë ka përskrime të tepërta të punëve, pa nevojë duke u mundue me tregue se është bërë punë e madhe. Po ashtu, ka përsëritje të panevojshme të përskrimit të projekteve të realizuara, psh nga Drejtoria e infrastrukturës, Arsimit, Shëndetësisë etj. Përskrimi i projekteve të realizuar ka mund të bëhet me një raport vetëm gjithëpërfshirës. Te raporti financiar, për shkak të planifikimit të keq Komuna e Obiliqit, nuk ka arritë me shpenzue buxhetin e saj. Sipas analizës tonë të dalë nga raporti Komuna, nuk ka arritë të shpenzoj 1 milion e 800,000 €, edhe më shumë se kaq kishin shkue në suficit edhe në vitin 2019. Pak ka rëndësi që një pjesë e këtyre mjeteve, janë nga të hyrat vetanake dhe i mbesin Komunës. Po ashtu, fati i investimeve dhe kjo godit qytetarin në Komunën e Obiliqit. Në këtë suficit milionësh, çdo vit i humbë edhe kuptimi i Ligjit për Obiliqin. Nëse, e marrim vitin 2019 dhe vitin 2020, janë përafërsisht që po e humbim buxhetin e Ligjit të Obiliqit për 1 vit, afër 4 milionë, që i kemi marrë nga Ligji për Obiliqin, duke e falenderuar gjithmonë LB-në dhe PDK-në, që i kanë ndihmuar qytetarët në Komunën e Obiliqit. Te Zyra e Prokurimit, këtu çdo vit kemi problem, manipulime dhe këtë vazhdimësi e konstaton edhe raporti i auditorit për vitin 2020. Ajo që bjen në sy është lidhja e kontratave të ndryshme, psh një kontratë është lidhur me çmim shumë më të ulët se mjetet e planifikuara që dëshmon planifikimin e dobët, që për pasojë ka shkuarjen e mjeteve të mbetura nga këto projekte në suficit. Ajo që është më shumë shqetësuese është lidhja e disa kontratave me çmime edhe në centë me vlerë të njejtë, e pa planifikuar psh projektet: rregullimi i mirëmbajtjeve me mjete të planifikuara 90,000 €, kontrata e lidhur po aq 90,000 €. Këtu, a ka që më bind se nuk ka keqpërdorim, ose keqmenaxhim kur për një kontratë kërkohen 90,000 €, dhe lidhet 90,000 €. Ndërtimi i rrugëve me zhvarorr, mjete të planifikuara 90,000 €, ndërsa kontrata e lidhur po aq 90,000 dhe kjo është për mu befasue. Mirëmbajtja e objekteve komunale, të planifikuara 94, 411 €, ndërsa kontrata e lidhur 94,411 €, e pabesueshme është e njejtë me centë 00. Kjo dëshmon se zyrtarët e Prokurimit lidhin kontrata duke negociju me firmat që ata i favorizojnë, sigurisht për interesa e përfitime. Po ashtu, është edhe një kontratë furnizimi i pajisjeve me IT, që ka qenë e planifikuar 30,000 €, kontrata është lidhur 32,203 €. Pra tejkalmi është antiligjor me lidhë këtë kontratë, pasi që janë tejkalue mjetet që kanë qenë të planifikuara. Diçka që më befason dhe më shokon është gjendja e kontratave me zhavorr, që sinjerisht dhe miqësisht po ju them se sa herë që dalin 90,000 €, dhe 100,000 €, kur të vjen 3 mujori i parë nuk ka zhavorr. Këtë punë e ka krye një drejtor shumë i ndershën në lagjen tonë një kanalizim z. Fatmir Bërbatovci, që kam kërkuar si anëtar i Kuvendit, si shef i grupit të hudhet një kamion zhavorr, por nuk është hudhë sepse nuk kanë pasë kontratë kur ka pasë zhavorr. Është edhe një gjë shumë më e keqe se rruga që është shtruar në vitin 2019, rruga te “Përroni” e deri te lagjja “Sadiku” është dëmtuar, e kam lajmëruë drejtorin, kam kërkuar që mos të mbetet ashtu dhe ka ardhë një kamionetë jo zhavorr, por po ju them miqësisht për ne ishte baltë. Sotmë vjen keq me i ra andej dhe me i pa ata qytetarë që në fakt kalojnë dhe e shohin se qysh punohet. Unë nuk kam kritikue pse është prish asfalti, por kam kritikue pse nuk ka qenë mundësia me hudhë një kamion zhavorr sepse çmimet që i ndajnë për vit janë marramendëse. Kjo shumë herë më bind se këtu, bëhet keqpërdorim nëpër shumë Drejtori dhe nuk dua të kthehem nëpër çdo sektor, por kërkova të jetë prezentë Kryetari. Unë do të mundohem që kësaj radhe përgjegjet ti marrë nga Kryetari,

e jo nga bartësit e tij, jo nga Nënkyetari sepse ai është përgjegjës, ai është udhëheqës i Komunës, që me ditë se çka po bëhet me këtë që po e quaj keqpërdorim, keqmenaxhim, manipulim etj.

Kryesuesi – Fushata i ka afër 6 muaj, por flasim.

Lulzim Sadiku – Nuk jemi duke folë si në fushatë, por po flasim me pika dhe me shifra.

Nazmi Gashi – Unë nuk e di se a është raport i Kryetarit, apo raport i drejtorëve, por besoj se puna e drejtorëve përfshihet edhe në raportin e Kryetarit. Unë sot mora shqetësimin prej qytetarëve të Sibofcit, që kanë shkue disa makina për rrënim të objekteve dhe a është me leje, apo pa leje drejtori i inspeksionit duhet me na tregue diçka. Ne kemi kërkuar makinat me shkue atje me i qelë rrugët prej borës, atëherë shkuan në mëngjez me rrëzue shtëpi, thua se atje kanë ndërtuar pallate. Mendoj se është mirë që qytetarët dhe anëtarët e Kuvendit ta dijnë se deri ku ka mbërri zona e interesit e ekspropriimit të KEK-ut, zona e parë, zona e dytë sepse nuk kemi asnjë shenim. Ne kemi telefonata dhe ankesa prej qytetarëve për këtë çështje dhe është mirë që dikush të na i shpjegoj.

Ibush Mjekiqi – Raporti i Kryetarit është i përpiluar mbi 85 faqe, që përshkruhet një punë voluminoze, që është bërë në vitin e kaluar. Ne e dijmë se viti i kaluar ka qenë një prej viteve më të vështira për shkak të pandemisë, e cila e ka përfshi tërë globin dhe e dijmë të gjithë se çfarë vështirësi ka pasë gjatë realizimit të projekteve. Mua, më vjen shumë keq që anëtari i PDK-së, ka të drejtë të japë vërejtje, por qysh asnjë fjalë të mirë nuk e gjen në këtë raport. Keqpërdorimet, keqmenaxhimet, keqplanifikimet, që u përmendën nuk qëndrojnë asnjëra dhe në anën tjetër nuk don përgjegje prej Nënkyetarit. Ne jemi strukturë, ne jemi qeveri të cilën nuk e ke përcaktue ti, as unë, por e ka përcaktue vota e qytetarit, prandaj edhe jemi këtu. Në natyrën time nuk është, por me injorue në atë masë nga unë nuk ke me pritë kurrë, e ti injoro sa të duash. Për rrugën në Sibofc, ti e din që jemi përballë me vërshime, me reshje të mëdha dhe është e vërtetë, që ka rrëshqitë toka në atë rrugë, por pse nuk e thua edhe më tutje se rruga është shumë e prishur, por vetëm rrugën e cila është ndërtuar në mandatin tonë. Këtë rrugë nuk kemi mund me rregullue, por do të sanohet në momentin e parë të mundshëm. Ne do të vazhdojmë të punojmë qysh kemi punuar deri më tash dhe qëndrimet e tua për kontratat duhet me pasë shumë njohuri pastaj, me kritikue. Zyra e Prokurimit, nuk lidhë kontrata, por Ligji i Prokurimit dhe nëse, ke dëshmi janë organet përgjegjëse dhe unë nuk i pranoj ato që i the ti sepse nuk qëndrojnë.

Lulzim Sadiku – Unë fillimisht kërkoja të shtyhet raporti pasi që Kryetari nuk është këtu, sepse për raportin në fjalë është dashur të jepë përgjegje Kryetari. Sa i përket atyre që ti nuk i pranon, është një diçka që i kemi marrë prej zyres së auditorit dhe unë krejtë ato që i thashë i kam marrë brenda raportit të Kryetarit prej 85 faqeve dhe asnjëra nuk e kam shpif. Me thënë që ka sukses dhe punojnë mirë drejtorët dhe po teprojnë një milion e 800,000 €, vërtetë është qesharake. Unë nuk kam ardhë këtu, me ofendue askend nga drejtorët dhe e përmenda çështjen e rrugës që ka mund edhe me ndodhë, por thashë se nuk ka pasë zhavorr, kërkoja prej të gjithëve me shkue me pa aty me hudhë një kamion me dhe. Unë akuzova për zhavorrin që në fakt nuk po planifikohet mirë dhe po jepë kontrata brenda 2 mujorit, herën e parë që po ndahen 80,000 €, 100,000 €, e përmbi po mbetemi pa kontratë të punës. Për të gjitha shifrat që i kam dhënë për zhavorr, mirëmbajtje të parqeve dhe për të gjitha i kam marrë brenda raportit prej 85 faqeve, që për juve, nëse teprojnë një milion e 800,000 €, mendoni se është menaxhim i mirë.

Kryesuesi – Më fal që po të them, por nuk ke ditë me lexue mirë.

Lulzim Sadiku – Ke të drejtë se ti vërtetë din me lexue, i din shkronjat se ke punue edhe si pedagog, është shumë e vërtetë.

Kryesuesi – Askund nuk shkruan se kanë mbetë suficit një milion e 800,000 €, dhe kjo nuk është e vërtetë. Ju, duhet ta lexoni raportin mirë sepse kontrata është kornizë dhe shërbimet janë për 3 vjet. Në asnjë faqe të raportit nuk the që kjo e kjo Drejtori, ka qaq mungesë dhe mua më vjen keq se je i keqinformuar dhe me ra në lajthitje prej njerëzve që nuk dijnë me lexue raportin financiar, nuk është e ndershme. Këto, fjalë mbesin të shkruara dhe dikush i lexon nesër. Më vjen keq z.Lulzim që je i informuar nga statuset e facebook-ut. Ju e dini se viti 2020, ka qenë vit i sfidave, vit i pandemisë, por kurrë në raport nuk shkruan 1

milion e 800,000, është gabim sepse janë 970,000 €, janë 370,000 të ngrira dhe 450,000 €, të bartura me buxhet. Prandaj, duhet të mësohemi të gjithë se fjalën publike kur e thua duhet me thënë me përgjegjësi.

Lulzim Sadiku – Ju, kryesues jeni bërë si hoxhë, je bë shumë i mençëm vetëm se po harron se sot duhet me i rishikue 9 vendime, që e kalojnë milionin, që ty ti kanë kthyer prapa. Unë nuk i paskam lexuar raportet, por ju garantoj juve, se janë mbi një milion e 800,000 €, që bëhet rishikim. Unë edhe në seancën e fundit se kanë qenë 46 % e buxhetit, që kam dhënë vërejtje e sugjerime, prandaj mos u mundo me gjuajtë topin në paaftësinë dhe menaxhimin e keq. Unë në seancën e fundit kur e kam parë se duhet të rishikohen 9 vendime, vërtetë e kam parë punën tënde, ti lexon mirë, je shumë i suksesshëm dhe kam kërkuar me dhënë dorëheqje. Mendoj se me pasë anëtarë të Kuvendit, që pranon me u rishikue 9 vendime, mbi 10 milionë €, vlerë vërtetë kjo nuk vlen me diskutue. Kjo është me të ardhë keq kur mundohesh me u arsyetue, kur mundohesh me mashtrues, ndërsa unë po flas me shifra të sakta, me gjëra kryesore thelbësore që janë në faqen zyrtare.

Kryesuesi – Vendimet e Kuvendit janë kthye në rishikim që askund nuk thuhet se Kuvendi komunal bazën ligjore e ka gabim. Mirëpo, çdo lëndë i ka munguar diçka që nuk është punë e Kuvendit, por e Ekzekutivit dhe ne e respektojmë afatin ligjor për rishikim të tyre.

Zarife Behluli – Komuna e Obiliqit, ka pasë sukses në menaxhimin e parasë publike pavarësisht se a janë mjetet nga buxheti i shtetit, apo nga të hyrat vetanake. Ne kemi arritë me realizue buxhetin 85.84, që do të thotë 86 % është realizue buxheti komunal. Ju e dini se në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit, janë ndarë mjete për të prekurit me Covid 19, kemi bërë deziinfektim të objekteve, kemi ndarë pako ushqimore për familjet që kanë pasë nevojë. Te investimet kapitale përqindja e realizimit është 78 %, vlera e investimeve kapitale i kemi 268,241 €, të bllokuara në bankën qendrore nga mjetet e shpronësimit të tokave, që ato janë në Gjykatë. Në raport nuk delë shpenzim sepse janë mjete të bllokuara. Te mallrat dhe shërbimet shpenzimi është 72.40 %, te shpenzimet komunale shpenzimi është 76.45%, te subvencionet dhe transferet 80 %. Në muajin shkurt ju kam tregue se jo vetëm Komuna e Obiliqit, por të gjitha Komunat e Kosovës dhe Ministrinë, shpenzimin që e kemi realizue ne në sistemin që ne punojmë Ministria e financave, i ka alokue disa pagesa tona, që vlera e tyre arrinë në 109,651.75. Mjetet që kanë mbetë të pashfrytëzuara nuk është fajtor Komuna e Obiliqit, por organi shqyrtues i Prokurimit publik, që këtë çështje ua sqaron menaxheri i Prokurimit. Te të hyrat vetanake të dedikuara kanë qenë një milion e 22,665 dhe i kemi realizue 881,168.63 të parealizuar janë 141,496.37. Në këtë pjesën e parealizuar 39,070 €, me vendim të Kuvendit komunal i kemi lirue bizneset në kohën e pandemisë nga taksat komunale, që nuk kanë punue fare dhe kanë qenë të dëmtuara. Do të thotë se është dashur me realizue, por nuk kemi mund 102,425.37 dhe këtë jam mundue me ua sqarue detalisht. Po ashtu 483,150.85 në muajin shkurt keni marrë vendim me bë bartjen e mjeteve.

Sherif Hoti - Z.Lulzim, unë në Prokurim punoj që nga viti 2003, dhe ende asnjë akuzë, asnjë vepër nuk e kam pasë dhe më vjen shumë keq prej teje me akuzue pa ditë. Nëse, nuk e njehë Prokurimin eja kur të duash dhe të tregoj pse janë lidhë ato kontrata ashtu, prandaj mos fol dhe mos akuzo me fjalë të rrugëve sepse është e pa pranueshme. Unë e ndjej veten shumë keq, kur dikush e akuzon dikend pa bazë. Akuzat nuk janë me thënë se ka keqpërdorë Prokurimin, pa bazë sepse Prokuroria është dhe dërgo lëndën atje. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, pyetjet të cilat i ka parashtruar z.Lulzim, kanë qenë edhe më heret më kujtohet se z.Aziz, i ka pasë që ia kam sqaruar dhe më vjen mirë që e ka kuptue. Kontratat kornizë kur lidhen për njësi çmimi delë ndoshta 100 €, por kur nuk e din njësinë psh heqja e borës, nuk mund të dish se sa ke me heqë borë gjatë vitit, a ka me rënë borë apo nuk ka me rënë borë. Pra, lidhet kontrata për njësi, as nuk kryhet punë, as nuk bëhet pagesa, shuma e kontratës edhe pse është lidhë e planifikuar me centë që po thua ti, ajo ka qenë kontratë për njësi dhe lidhet shuma në bazë të buxhetit që e ke. Kjo, nuk do të thotë se shpenzohen 90,000 €, që e the, por është kontratë me çmimin për njësi, aq sa kemi punë aq edhe bëhet pagesa. Ky raport që ka ardhë te ju, i njejtë është edhe në Prokurim publik. Edhe te auditori general në vitin e kaluar, e keni lexuar të gjithë atë raport dhe asnjë vërejtje nuk e kam në Prokurim. Prandaj, për mua është e pa pranueshme me akuzue dikend pa bazë. Te rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, planifikimi ka qenë 90,000 €, kontrata është lidhë 90,000 €, hajde z.Lulzim në zyren e Prokurimit, ta tregoj procedurën dhe bindesh ashtu qysh po të them unë. Këtë raport e ka edhe KRPP-ja, e kanë edhe auditorët, ky raport është edhe në

web faqen e Prokurimit si dhe në faqen e Komunës. Te korrigjimi me pajisje të kompjuterëve, vlera ka qenë 30,000 €, tenderi ka ardhë 32,000 €, dhe ne nuk e kemi lidhë kontratën pa i sigurue edhe 2,000 €, për mos me anulue tenderin. Kjo, nuk është shkelje, ne kemi qenë shumë transparentë dhe është taman ashtu qysh është.

Kryesuesi – Ju, më vjen keq se nuk dini me lexue raportin as të Zyres kombë tare të auditimit, as raportin prej 85 faqeve, sepse e lexon ashtu qysh don ti.

Lulzim Sadiku – Unë vërtetë thashë keqmenaxhim dhe keqplanifikim, por më befason fakti që po thuani po merreni me rrjete sociale, ose po merreni me njerëzit jashtë. Unë nga ajo që kam dëgjue jashtë është interesantë se thojnë e kanë lëshue AAK-në, kanë dhënë dorëheqje, kanë shkue në një subjekt tjetër KFE, kah fryen era, po kalojnë në Vetëvendosje. Unë shifrat që i ceka i kam marrë nga raporti i Kryetarit të Komunës. Tani, te rendi i ditës shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kastrioti”, kjo nguti te rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve te planifikimi mjeteve prej 90,000 €, kontratë për të lidhur ka mund të kryhet edhe për pikën e 4 të rendit të ditës, që e kemi. Këtu, është keqmenaxhimi sepse vërtetë ka shumë dëmtime në infrastrukturë, gjelbërim, po bëhen 8 vite dhe asnjë dru nuk është mbi 2 e 40. Unë të gjitha këto të dhëna i kam marrë te çështja 32,203 €, për tejkalimin që është antiligjore sepse nëse, ti vërtetë e ke kërkuë me bë 30,000 €, dhe ka dale 32,000 €, planifikimi nuk është i mirë sepse është dashur me rritë vlerën. Qëllimi nuk është me bë politikë, por qëllimi është me zberthye. Edhe te rrënimi i objekteve planifikim 90,000 €, ndërsa, këtu në rend dite ne mundohemi me bë një kompani që me i punësue qytetarët e Obilicqit. Këto, janë shifrat për të cilat po flasim.

Sherif Hoti – Z.Lulzim po akuzoni shumë rëndë, pa bazë dhe këtë nuk e pranoj sepse për akuza dhe shpifje mund të keni pasoja të mëvonshme. Ju duhet ti paraqitni argumentet se a kam të drejtë me lidhë kontratën për njësi me vlerën e paraparë sa ka qenë, që e di unë si Prokurim, e din edhe KRPP-ja dhe ti nëse, nuk e din hajde pyet. Për mua kurrë fushata mos të ndalet, por nëse mundohesh me shpifje për mua kurrë nuk ke me qenë i pranueshëm.

Lulzim Sadiku – Më befason fakti nganjëherë të thojnë po flet me fjalë të jashtit dhe kur dëgjon çfarë po thojnë nga jashtë shokohesh dhe befasoesh çka dëgjon brenda. Më befason fakti se shumë njerëz më japin vërejtje se a di me lexue, që kanë të kryer kolegje që e kalojnë shifrën mbi 80 % dhe kjo është tmerr, është për me të ardhë keq. Unë këtu, nuk jam qe një muaj, këtu jam qe 12 vite, por nuk është e drejtë dhe nuk është e sinqertë ata që përfitojnë prej një Kryetari me tregue se a di me lexue, apo nuk di me lexue. Për të gjitha këto që i thashë nëse, kam bërë shpifje dërgone në Gjykatë, por mendoj se Gjykata shumë shpejtë do të merret me këto çështje.

Kryesuesi – Unë e falenderoj Kryetarin dhe Ekzekutivin për punën e jashtëzakonshme që e kanë bërë sepse është bërë një raport në të cilin në mënyrë detale gjërat janë specifikue.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kastrioti” SH.A.

Ibush Mjekiqi – Së pari uroj që është finalizue ky vendim nga ju, pastaj i kemi ndërmarrë të gjitha hapat dhe kemi ardhë deri në këtë shkallë, ku Qeveria ka marrë vendim për themelimin e Ndërmarrjes. Prandaj, sot ju duhet ta formoni Komisionin dhe ne nga Ekzekutivi propozojmë z.Naim Miftari, për anëtar të Komisionit.

Enver Gashi – Edhe unë i bashkangjitem Nënkryetarit dhe uroj qytetarët e Obilicqit, për formimin e kësaj kompanie publike. Ne propozojmë z.Lulzim Bllaca, për anëtar të Komisionit.

Lulzim Sadiku – Unë vërtetë, e përgëzoj për këtë punë Kryetarin, Kuvendin komunal dhe e përgëzoj edhe ministrin në shkuarje, që e ka shtye këtë procedurë. Mendoj se në këtë Komision duhet të zgjedhen njerëzit ekspertë, njerëzit që dijnë dhe kanë përvojë shumë të madhe. Unë nga opozita e propozoj një njeri që ka përvojë shumë të madhe në Arsim, në çështje të luftës, si udhëheqës i çështjeve të ndryshme, me çështje juridike, një njeri që ka përvojë shumë edhe në Kuvendin komunal, një njeri që në fakt ka udhëheqë edhe

parti politike, një jurist që vërtetë është i njohur për qytetarët e Obiliqit, një njeri që ka vlera dhe virtyte për themelimin e shtetit, z.Hysni Mjeku.

Aziz Bici – Kërkoj sqarim lidhur me Komisionin se cilat detyra i ka.

Kryesuesi – Sqaron se ky Komision pothuajse e përfaqëson kompaninë publike, do ti japin raport Kuvendit komunal, do ta shpallim konkursin bashkë me administratën për përzgjedhjen e Bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes. Pastaj Bordi i drejtorëve, vepron sipas procedurave tjera ligjore. Pra, do të jenë monitorues të Bordit të drejtorëve, nëse nuk gaboje me një mandatë 3 vjeçar sipas ligjit.

Aziz Bici – Mua, më shtyri me folë pak propozimi i z.Lulzim Sadiku, nuk po them se e tha krejtë shaka, por po them se duke e parë të kaluarën e qeverisjes prej vitit 2000, kur janë mbajtur zgjedhjet e para lokale, mendoj se nuk mund ta gjejmë njeriun e fortë, asi asambleisti, asi aktivisti, që vërtetë ka vlera aq të mëdha për me vlerësue qysh tha z.Lulzim Sadiku. Ne e kemi votue Ndërmarrjen për pastrimin e Komunës tonë, ne kërkojmë dhe sigurisht se do ta përcjellim punën e këtij Komisioni. Shpresoj se do ta kryejnë punën me përgjegjësi sepse ka nevojë për formimin e një Ndërmarrje të tillë. Gjithashtu, e kam edhe një pyetje në rast se ka ndonjë Ndërmarrje private Komuna, me kontratë për pastrimin përveç asaj me Ndërmarrjen që e kemi.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet po kemi, sidomos është një kontratë për mirëmbajtje të parqeve dhe pastrim të rrugëve, është kontratë publike me kompani private. Esenca e formimit të kësaj kompanie është që më mos të lidhim kontrata me këto kompani për mirëmbajtje të parqeve. Po ashtu, e kemi edhe kontratën për pastrim të Komunës, apo higjienës komunale. Tani, me themelimin e kësaj kompanie, që jemi në finalizim, këto kontrata pastaj nuk lidhen më me këto kompani, por lidhen në mënyrë direkte me kompanitë në Ndërmarrjen publike.

Lulzim Sadiku – Unë z.Aziz Bici, pajtohem me atë që the se është kjo, por unë thashë shumë më pak se që është dashur të them. Singërisht brenda Komunës së Obiliqit, ose që është një fshat i vogël ku njihemi të gjithë në mes veti, unë pak kam thënë lidhur me atë që kam mund me folë sepse kur e përmenda kandidatin për çështjen juridike vërtetë kisha me folë ndoshta, edhe një orë e gjysmë. Mirëpo, unë fola në pika të shkuta sepse z.Mjekiqi, ka punuar në kohën më të vështirë në çështjen e Arsimit dhe është që nga themelimi i Arsimit, nga kuadrot e para që kanë fillue në Komunën e Obiliqit. Po ashtu, ka qenë pjesë e luftës që nga themelimi, ka qenë udhëheqës kryesor në sektorin për çështje të dokumenteve brenda Komunës dhe ka shumë e shumë me folë deri në orën 16, kur ju gjysma shkoni. Gjithmonë këtë që e them e vërtetoj dhe nuk e tejkaloj, por i them gjërat ashtu siç janë. Pra, them që brenda Komunës së Obiliqit, është një jurist që në kuadër të këtij profili është ndër më të mirët.

Aziz Bici – Me gjithë respektin që e kam për z.Hysni Mjekun për të kaluarën, unë po flas për z.Hysni si politikan, z.Hysni si anëtar i Kuvendit komunal. Ndërsa, nëse nuk gaboje në njërin nga seancat vetë është deklarue se ka qenë prej fillimit asambleist në Kuvendin komunal, do të thotë së paku shumë mandate. Ne e dijmë se nëpër çfarë vështirësish ka kaluar Komuna edhe në kohën e UNMIK-ut, ne e dijmë plotësimin e atyre standardeve të cilat është dashur me i realizue dhe sa na kanë kushtue. Unë atëherë nuk kam qenë në rrjedhat e politikës, por politikën e kam përcjellë. Unë prapë po ju them se rezultatit e asaj politike ne mundemi me vërejtë edhe sot, po na dalin të rinjët jashtë që mos me përmendë çdo detal. Sikur të ishte një qeverisje, sikur qytetarët të kishin besuar në institucione, unë mendoj se do të kishin një besim më të madh edhe në institucionet lokale dhe qëndrore. Vetëm mungesa e besimit në këto institucione i detyron të rinjët tonë me dalë jashtë shtetit. Prandaj, po them aty ku jam unë mos të lavdërohen aq tepër njerëzit si politikanë, e jo për të kaluarën e z.Hysni.

Lulzim Sadiku – Dua ta bëjë analizën e thukët sepse kur po i marrim vendimet është e vërtetë, por nuk do të kisha thënë se unë jam person që e quaj ekspertë dhe e vërtetoj këtë që e them, bota po lëviz, njerëzit shkojnë në Gjermani, gjermanët shkojnë në Amerikë, kjo është lëvizje në 20 vitet e fundit. Unë nuk po lavdërohem se është situata e mirë, por jemi në çështje lokale dhe jemi shumë të vogël të flasim për çështje madhore, që janë të nivelit qëndror. Prandaj, unë fola për personin në fjalë dhe mendoj se tash duhet ti

shikojmë rezultatet që kanë ardhë dhe situatat qysh janë. Prapë mendoj se njeriu i zgjedhur nga PDK-ja, në këtë Komision është ekspertë për vendin tonë dhe për Komisionin në fjalë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kastrioti” SH.A.me këtë përbërje: 1.Naim Miftari, Kryetar, 1.Lulzim Bllaca, anëtar dhe 3.Hysni Mjeku, anëtar.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Në mbledhjen e fundit edhe pse e votuam çështjen e 24 ha, edhe pse e votuam çështjen te INA, ku ishte ajo pjesë në interes të qytetarëve, unë kam kërkuar prej Kryetarit që kjo punë të shtyhet sepse kam pasë informatë dhe informatën e kam pasë kështu, qysh po e tregoj mos me përmendë emër dhe të mbetet konfidenciale. E vërteta është se ajo pronë është blerë dhe Kryeministri Kurti, në zgjedhjen e parë e ka ngri, njerëzit kanë shkue dhe e kanë blerë. Kryeministri e ka ngri punën e kësaj toke, e cila në fakt është lëndë gjyqësore. Unë jam pro kërkesës sepse Gjykata mund të jetë pozitive dhe negative, kështu që nëse, është pozitive është në interes të qytetarëve tonë dhe nëse, është negative fiton pronari i cili e ka blerë atë tokë, që është pjesë tjetër. Unë atë ditë kam kërkuar për pronën që po flasim te varrezat sepse e kam pasë një informatë të sigurtë kur e kam sqaruar delë se ai e ka blerë, por Kryeministri Kurti i ka ndërprerë aktivitetet dhe lënda ka shkue në Gjykatë. Unë jam pro që vërtetë, kjo të votohet.

Kryesuesi – Të gjitha vendimet neve, zyrtarisht na i dërgon Ekzekutivi dhe kjo është gjendja faktike zyrtare. Herën e kaluar kemi kërkuar që të shtyhet kjo çështje dhe nuk kemi marrë vendim. Meqë, nuk ka ardhë kurgjë, Drejtoria e ka përgatitë lëndën përmes Kryetarit për Kuvend.

Arben Berisha – Unë prita z.Lulzim, që po delë sepse ke thënë që ke me kërkuë falje. Sot nuk ke mund me sjellë në lajthitje Kuvendin, por atë ditë e ke sjellë në lajthitje sepse unë çka kam folë atë ditë, flas edhe sot. Unë flas me dokumente zyrtarisht si drejtori i Urbanizmit dhe Kadastrit dhe nuk ia jepi kot më ka thënë ai, e më ka thënë ky. Lënda është e pastër si loti dhe atë ditë i ke sjellë kolegët e tu në lajthitje, por sot nuk munde ti sjellësh në lajthitje. Tash, më mirë është me pranue fajin, me thënë më fal se nuk kam pasë informatë, por jo me dalë dhe me mbrojtë prapë tezën e asaj dite. Unë atë ditë kam qenë shumë i shqetësuar dhe nervoz pse ti arrite me i bindë ndërsa, unë me dokumente nuk arrita me i bindë. Ti i binde që është në shitje dhe as nuk është në shitje, as nuk e ka blerë askush, por prona është e AKM-së, menaxhon AKP-ja, me të.

Lulzim Sadiku – Unë nuk kisha për çka me kërkuë falje sepse e sqarova shumë qartë se kam pasë informatë shumë të sigurtë z.Berisha. Unë emrin tënd e kam parë edhe nëpër shumë rrjete sociale dhe e kam humbë shumë besimin sepse akuzohesh për shumë gjëra. Unë isha shumë i qartë se toka është blerë dhe pague, e ka ngri Kryeministri dhe thashë se e votoj. Mirëpo, me u sjellë në këtë situatën kështu, është mirë ta keni një konsideratë sepse nga drejtorët e kësaj Komune, vetëm emri yt përfillet nëpër Gjykata dhe polici.

Arben Berisha – Është e vërtetë se emri im lakohet nëpër Gjykata, nuk kam bërë dhunime kurrë, nuk jam marrë me hajni kurrë, as nuk jam marrë me prostitucion kurrë.

Lulzim Sadiku – Kush të akuzoj se je marrë me ato çështje.

Shaip Paloja – Unë nuk dola me debatue, ose me hy në mes të z.Lulzim Sadiku dhe z.Arben Berisha, por dua të tregoj se në seancën e kaluar unë kam votuar i vetmi kundër shtytjes së këtij vendimi vetëm për arsye se iu kam referuar dokumenteve zyrtare. Z.Lulzim, e përmende Kryeminsitrin z.Albin Kurti, Qeveria Kurti dje është votuar dhe që nga dje është Kryeministër z.Albin Kurti, do të thotë ka ekzistue edhe një Qeveri tjetër pas z.Albin Kurti, më heret. Unë iu kam referue vetëm dokumentacionit zyrtar dhe jam i vetmi që kam votuar kundër dhe kam qenë i bindur që kam të drejtë dhe po delë se aty kam pasë shumë të drejtë.

Hysni Mjeku – Paraprakisht i falenderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal për besimin e dhënë. Mua, pak ndërhyrja e drejtorit nuk po më pëlqen sepse sipas ligjit sot është dita jonë, e jo e juaja, ju jeni me na

dëgjue neve z.Arben, e jo me na bë replika dhe këtu, me na kundërshtue. Në fund të fundit edhe nëse, nuk ia qëllojmë e jona është me diskutue këtu. Ne për hir të asaj që mos me u neglizhue një procedurë e tillë nga se u tha se lëndëve u mungon diçka nga aspekti teknik, do të thotë fajtor je ti, e jo ne sepse ne kemi marrë një vendim. Askush nuk të akuzoj ty prej anëtarëve as për korrupsion, as për nepotizëm, prandaj sipas ligjit Ekzekutivi duhet të jetë më i disiplinuar, me i dëgjue anëtarët e Kuvendit. Ne kemi kërkuar me shtye këtë çështje sepse kemi pasë informacione të sakta dhe ne kemi mund me aprovue gjendjen faktike. Mirëpo, kur din se ajo tokë është e blerë prej dikujt unë e admiroj anëtarin e Kuvendit, që e ka parashtrur atë kërkesë këtu. Mbi të gjitha lënda është në proces gjyqësor dhe Gjykata sjellë vendim. Ti nuk ke qenë në gabim sa i përket kësaj që e ke parashtrur, por për derisa për shkaqe teknike të kthehen 9 lëndë, atëherë më tepër është dëm i yti se sa i joni sepse ne kemi marrë vendim, kemi konstatue se është në rregullë. Prandaj, nuk duhet me qenë tepër temperamentë sepse kritikant janë të mirëseardhura dhe të përmirësueshme, nuk ka njeri të pa gabueshëm, por me pranue gabimin është shumë njerëzore dhe shumë parimore.

Lulzim Sadiku – Drejtor, është mirë me i thënë ato që i ke pasë dhunime, kidnapime, kërcnime, por jo si njeri lavire e politikës me akuzue njerëz që marrin besimin. Ti ke ardhë si lavire e politikës nëpër Drejtori ku udhëheqë dhe 9 vendime i ke që duhet të rishikohen. Atë ditë nuk të kam akuzue, kam thënë kërkoj falje dhe tash po të them në mënyrë kolegjiale, se do ta sjellë fletën nesër që njeriu e ka blerë. Tani, pse ka shkue nuk kam qëllim të keq se atë ditë i kam votue 26 ha, e janë në pyetje mbi 4 ha. Mendoj se nuk është bërë nami pse është shtyer për një muaj ditë sepse kemi pasë informatë se e ka ble, e di atë dokumentacion.

Arben Berisha – Ty. z.Lulzim, duhet me të ardhë turp çka flet, një njeri i votuar që mendon me qenë dikushi, por kurrë nuk ke me qenë dikushi. Ti me thënë lavire, ky është turp, ky është fjalori yt, tregoju këtyre që e ke mizën pas veshi dhe qysh vijë unë nëpër poste politike, këtë e dijnë të gjithë. Mirëpo, më së miri e din z.Xhafer Gashi, ai që më ka emëruë, e ti kontrolloje pak veten sepse duhet me pasë kulturë, aq më tepër kur thua se ke qenë profesor, kend e ke edukue, turp.

Lulzim Sadiku – Ti, kur folë qysh kam ardhë, qysh kam punuar unë si profesor, nuk di dhe nuk më kujtohet a të kam pasë nxënës, në jetën private, apo jo. Mirëpo, unë e di qysh ke ardhë, qysh ke studjue, qysh ke punue, qysh ke notue, të gjitha fatmirësisht i dijmë. Vërtetë, më vjen keq kur ti mundohesh me më mësue mua çfarë drejtorë të lartë ka Komuna dhe kërkoj falje që e thashë në shumës sepse ka edhe shumë të mirë në mesin e tyre.

Kryesuesi – Nganjëherë kështu e ka demokracia dhe Rregullorja, por nuk e thotë demokracia me kalue në nivelin personal. Unë po e them me përgjegjësi se kurrë në jetë nuk e marrë si personale sepse çdo gjë që mbetet, mbetet brenda nivelit të diskutimit publik, ajo që është më e mira për qytetarë. Ne atë ditë e kemi shtye çështjen për mbledhjen e radhës sepse ne nuk e kemi kontestue gjendjen faktike, por në bazë të informacionit që disa kolegë kanë pasë, e kemi shtye për mbledhjen e sotme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për e aprovuan Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Edhe ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Xhezide Draguaha – Ne jemi kundër.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për dhe 2 vota kundër e aprovuan Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal, a) vendimi nr.-I-09, i dt.29.01.2021.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Unë kisha dashur që secilin vendim veç e veç ta diskutojmë dhe bisedojmë sepse jemi këtu, me qëllimin që kur po kritikojmë ka Ekzekutiv të mirë, ka zyrtare ligjore të mirë, ka projekte të mira, ka menaxhime të mira, por iu mungojnë 3 fletë një operatori ekonomik i cili e ka marrë një pronë të shtetit. Mendoj se dhënia e tokave nga Kuvendi komunal, është çështje e pa planifikuar, e pa analizuar sepse që 7 vjet, japim prona në këtë formë dhe asnjëherë nuk e kemi një shkrim të një operatori ekonomik i cili ka premtuar ti punësoj 20 vetë, ose 2 vetë, e nuk i ka punësue. Ne po shkojmë për 7 vjet, për 8 vjet që japim prona dhe asnjë operatorë që ka marrë vlerën e tokës milionëshe, nuk e ka punësuar asnjë punëtorë. Unë kërkoj që rishqyrtimet e këtyre vendimeve, mos të hyjnë në rend dite, të shtyhen sepse janë të pa planifikuara dhe të pa analizuara. Është mirë që pas gjithë kësaj pune dikush nga Ekzekutivi, Drejtoria përkatëse, ose Zyra ligjore me u ndje keq dhe me kërkue falje, ose me ndërmarrë masa që njerëzit e paditur mos me i lënë në Komunë sepse janë shumë vendime. Unë jam kundër rishikimit të këtij vendimi.

Aziz Bici – Ne jemi kundër rishikimit të këtij vendimi.

Armend Rushiti – Ne jemi kundër marrjes së këtij vendimi.

Hysni Mjeku – Unë e kam vetëm një pyetje për këto 9 vendime, e lus drejtorin të japë arsyetim se cili dokument i ka mungue këtyre akteve, do të thotë në aspektin teknik çka i mungon çdo lëndë. Po ashtu, është dashur ti thuhet ofertuesit me kompletue lëndën sepse me na u kthye vendimet performanca e Komunës tonë, bjen nën mesatare. Edhe kuvendarët nuk janë fajtorë sepse ne veç kemi marrë vendim

Arben Berisha – Është shumë e natyrshme me u folë në këtë gjuhë dhe ne si drejtorë e pranojmë çdo vërejtje, çdo kritikë dhe çdo lëshim që është bërë. Lënda e njëres nga kompanitë ka qenë voluminoze dhe ne nuk kemi mund me skenue deri në 500 faqe, por e kemi skenue lëndën e parë të kompanisë, është qarkullimi i fundit ua kemi dërgue. Ata e kanë marrë si të pabazë se nuk është komplet qarkullimi banker dhe tash qysh me i skenue 500 faqe. Ne e kemi thirrë kompaninë dhe i kemi thënë me na sjellë një USB, për skenim të atij materiali. Ne çdo herë e kemi dërguar kështu dhe gjithë e kanë pranue, por tash ka ndodhë e kanë kthye. Këtu, nuk është bërë ndonjë gabim, apo falsifikim përveç se është kërkuar material shtesë dhe atë dokumentacion shtesë ne e kemi përmes emailit që e kemi dërgue. Thuhet se i mungon çertifikata e biznesit dhe ne nuk mundemi me dërgue materialin pa çertifikatë të biznesit, por kjo ka ndodhë sepse është fushatë, janë zgjedhjet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan Vendimin për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit N.P.SH. "Termopan" me adresë Prishtinë, Velani.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal b) vendimi nr.-I-10, të dt.29.01.2021.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, nuk e di se çka i mungon kësaj lëndë sepse nuk na keni dhënë informata të sakta. Materiali që na ka ardhë po i bjen se secilës lëndë i mungon një pjesë e materialit, kështu që materiali na ka ardhë vetëm pjesërisht.

Kryesuesi – Materiali ju ka ardhë dhe nuk mund të thuash pjesërisht ndërsa nëse, nuk don me votue është çështje tjetër. Ju, duhet ta thoni të vërtetën se materiali ka ardhë, por nuk e kam lexue sepse është e pa përgjegjshme me thënë se nuk më ka ardhë materiali. Materiali ju ka ardhë të gjithëve, në emailin zyrtar dhe privat.

Lulzim Sadiku – Materiali vjen ditën e fundit, ditën e parafundit dhe unë e kam pa materialin që na ka ardhë shumë më heret, por edhe sot na ka ardhë një material në Kuvendin komunal. Materiali në të cilin janë të grumbulluara të gjitha bashkë dhe ato janë ashtu qysh është Komuna, por unë ato nuk i lexoj, mirëpo, materiali që jemi mësue me na ardhë ditën e 3, ose 4, nuk na ka ardhë.

Kryesuesi – Unë sinqerisht habitem sepse i gjithë materiali ju ka ardhë 9 ditë para mbledhjes dhe është e pa vërtetë ajo që e thua.

Aziz Bici – Ne jemi kundër marrjes së këtij vendimi.

Armend Rushiti – Edhe ne jemi kundër marrjes së këtij vendimi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit Tehno Burimi D.D SH.A me adresë Shupkoc – Mitrovicë.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal c) vendimi nr.-I-11, të dt.29.01.2021.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Ne jemi kundër.

Aziz Bici – Ne jemi kundër marrjes së këtij vendimi.

Armend Rushiti – Edhe ne jemi kundër marrjes së këtij vendimi.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit NMA SH.P.K.me adresë Prishtinë.

Kryesuesi - Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal d) vendimi nr.-I-12, të dt.29.01.2021.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit“N.T.P EBF” me adresë Prishtinë.

Kryesuesi - Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal e) vendimi nr.-I-13, të dt.29.01.2021.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit “BP Home Invest SH.P.K.me adresë Prishtinë.

Kryesuesi - Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal f) vendimi nr.-I-14, të dt.29.01.2021.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Aziz Bici – Ne jemi kundër marrjes së këtij vendimi.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit“Aztech SH.P.K.” me adresë Graqanicë – Llapnasellë.

Kryesuesi - Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal g) vendimi nr.-I-15, i dt.29.01.2021.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit One group SH.A.me adresë Fushë Kosovë.

Kryesuesi - Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal g) vendimi nr.-I-16, i dt.29.01.2021.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit “N.P. Tro-dex” me adresë Fushë Kosovë.

Kryesuesi - Paraqet kërkesën nga MPL-ja, për rishqyrtim të vendimit të Kuvendit komunal g) vendimi nr.-I-17, i dt.29.01.2021.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për dhe 6 vota kundër e aprovuan vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit “Nic Home SH.P.K” me adresë Milloshevë-Obiliq.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi –Paraqet kërkesën nga Drejtoria e financave për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të dt.11.12.2020.

Ibush Mjekiqi – Ju njoftoj se në Komunën tonë deri më tani janë marrë 3,370 mostra, prej tyre 1,351 kanë rezultue pozitiv, 1,091 janë të shëruar, 224 për momentin i kemi aktiv me Covid 19, që prej tyre 18 janë dërguar në IKSHP dhe 5 janë të hospitalizuar, por me gjendje statike. Fatkeqësisht prej fillimit të pandemisë deri më tash janë 36 të vdekur. Kërkoj që ju tash të merrni vendim për përkrahjen e banorëve të Komunës tonë derisa të shpallet pandemia e përfunduar.

Lulzim Sadiku –Vërtetë, kur është marrë ky vendim kemi qenë prezentë unë, z.Aziz Bici dhe Kryetari e ka arsyetue se kanë qenë 90,000 €. Mendoj se rishikimi i këtij vendimi është i arsyeshëm dhe unë pajtohem plotësisht sepse e jepë të thukët gjendjen reale, është i arsyetuar në mënyrën më të mirë që të bind se duhet me rishikue.Unë jam pro këtij vendimi sepse gjithçka është në nivelin e duhur, prandaj plotësisht pajtohem dhe tërësisht të marrim vendim aq sa ka nevojë, por gjithsesi duhet me rishikue.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal, unanimisht e aprovuan vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimin nr.-350, të dt.11.12.2020, për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere për përkrahjen e banorëve të prekur me Covid 10, të Komunës së Obiliqit.

Kryesuesi – Ju njoftoj se në mbledhjen e KPF-së, e kemi pasë një Ankesë nga Gani Berisha, të cilën ia kemi rekomanduar DPUKP-së, për shqyrtim, ndërsa 2 kërkesa tjera për emërim të rrugëve mbeten të trajtohen përmes Komisionit.

Pika 9 e rendit të ditës

Enver Gashi – Unë dola ti sqaroj fjalët e thëna që po qarkullojnë në Obiliq. Është e vërtetë se ne grupi i AAK-së, prej 6 anëtarëve të Kuvendit dhe 3 të LDK-së, që na janë bashkangjitë kemi vendosë prej këtij momenti të jemi anëtarë të Kuvendit pa llogon e Aleancës, jemi të pavarur.

Aziz Bici – Mendoj se pas informacionit që na dha z.Gashi, sigurisht se edhe z.Shaip, do të na jepë një sqarim lidhur me këtë informacion që e ka dhënë sepse në mbledhjen e kaluar ka thënë se unë duhet të qëndroj me llogon e LDK-së, sepse përndryshe unë do të vazhdoj me qenë kandidat i Asamblesë komunale. Sido që të jetë unë kam dalë këtu, lidhur me një kërkesë të z.Fadil Curri, nga fshati Mazgit i Ulët, me numër të protokollit të kërkesës 02-070/05-0000822/21,edt.14.01.2021.Kjo kërkesë ka të bëjë me formimin e bibliotekës në shkollë fillore “Ibrahim Rugova” mësimi i ulët në fshatin Mazgit i Ulët. Sipas materialit që ia ka bashkangjitë kërkesës, biblioteka është inaguruar me dt.23.04.2018, megjithëse 714 ekzemplarë të librave nga autorë të ndryshëm, ku deri në muajin mars të vitit 2020, është pasuruar vazhdimisht edhe për 600 libra, shumica e tyre të regjistruara. Neve, zakonisht së bashku me materialin për mbledhjen e Kuvendit komunal na dorëzohen kërkesat e qytetarëve, por në këtë rast nuk është bërë një gjë e tillë. Prandaj, pyetja ime është pse kjo kërkesë nuk është sjellë te ne. Kërkesa ime është pse nuk e keni shqyrtuar kërkesën e z.Fadil Curri, që brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të ia ktheni një përgjigje. Mendoj se edhe ju jeni të mendimit se në çdo shkollë duhet të ketë një kënd të librave, ku është më pas një bibliotekë siç e ka formuar z.Curri. Shpresoj dhe e lus Drejtorinë e Arsimit komunal ta shqyrtoni kërkesën e z.Curri dhe të konstatooni se edhe çka duhet plotësuar kushtet tjera, në mënyrë që edhe këto kushte të plotësohen. Si dhe kërkoj që t’i kthehet përgjigja z. Currit, sipas procedurave.

Ibush Mjekiqi –Pyet se çka është kërkesa konkrete nga Fadil Curri.

Aziz Bici – Përgjegjet biblioteka të bëhet funksionale.

Ibush Mjekiqi – Ajo është funksionale se hapësira dhe librat ekzistojnë dhe Drejtoria e Arsimit, e menaxhon atë. Nxënësit mund ti marrin librat dhe ti lexojnë, por çka është kërkesë tjetër e tij.

Aziz Bici – Unë për këtë arsye thashë se Drejtoria e Arsimit Komunal, duhet ta analizoj kërkesën, se aty e ka edhe numrin e telefonit z.Fadil, që mund ta kërkonti, të takoheni me të dhe e shihni se cilat janë kërkesat e tij. Sipas tij biblioteka nuk është funksionale dhe unë e kam parë, por nuk thirrem se jam ekspertë i saj dhe mundem me dhënë një mendim që me i kontribue kësaj çështjeje. Mirëpo, unë them se nuk i plotëson kushtet aty, ku është biblioteka, qysh e kam parë ajo gjendet në korridor. Prandaj, kërkesa ime është e qartë Drejtoria e Arsimit Komunal, është mirë të shkoj dhe të shohë se biblioteka a i plotëson kushtet në përgjithësi.

Kryesuesi –Kjo kërkesë me numër 02, është për Zyren e Kryetarit, ndërsa, kërkesat që vijnë për shqyrtim në Kuvend, është numri 01.

Ibush Mjekiqi –.Aziz Bici, ka të drejtë që e paraqiti kërkesën dhe ne do ta shikojmë se a iu ka kthye përgjegje qytetarit.

Nazmi Gashi - Unë bisedova me drejtorin, i cili më tha se unë jam në gjendje me u përgjegjë për këto kërkesat tuaja. Komuna e Obiliqit ndahet në zona kadastrale, zonat kadastrale përbëhen dhe ndahen në parcela. Prandaj mos u hyni në hak qytetarëve sepse unë sa kam punuar si kryeinspektor kur kanë ardhë qytetarët, ata nuk kanë ditur se çka është fleta poseduese, çka është zona kadastrale dhe çka është sistemi administrativ. Për këtë arsye ne jemi këtu, në shërbim të qytetarëve që me iu ndihmua atyre. Ne nuk jemi këtu, me tregue sa jemi të mençëm sepse me punë e tregojmë veten sa jemi të mençëm. Unë e lus drejtorin e DPUKP-së, me dalë me na ndihmua se çka është interes i shtetit të dijmë. Unë po dëgjoj qytetarët që po ankohen se nuk kemi të drejtë ti legalizojmë objektet, shtëpitë në Hade dhe në Sibofc, por shtëpitë që 120 vjet që kanë qenë aty. Ndërsa, ne ju japim prona njerëzve që nuk i njohim hiç për interes të Komunës, prandaj për çka ne jemi ardhë këtu. Mendoj se duhet me iu ndihmua njerëzve në këtë drejtim. Të lutem drejtor me na tregue për Sibofc, se deri ku është zona e interesit të KEK-ut, cila është zona e eksploatimit të thëngjilli edhe sa vite për afërsisht vjen deri te shtëpia ime, të di a mund të ia nisë me bë diçka, ti mbledhi gjërat dhe të eci nga aty.

Arben Berisha – Përgjegjet zonë me interes nacional quhet fshati Palaj, Hade, Lajthishta, Sibofci, Shipitulla dhe Hamidia me vendim të Kryeministrit. Ne e kemi paraparë me planin e ri zhvillimor që e kemi në Ministri për shqyrtim se duhet me funksionalizue jetën e qytetarëve atje. Do të thotë e kemi paraparë edhe pjesën e zhvillimit të KEK-ut, deri në 60 vite, me dhënë edhe aty leje të përkohshme, për aq sa e ka parapa KEK-u, zhvillimin e tij. Edhe fshati Palaj, Lajthishtë, në Sibofc pjesërisht është heqë krejtë sepse nuk shtrihet KEK-u aty. Ne kemi njoftue dhe kemi shpërnda informata se njerëzit kanë të drejtë me bë kërkesën për legalizim, por mbeten në listë të pritjes, do të thotë deri në një vendim të ardhshëm të një Kryeministri, i cili do ti legalizon ato objekte. Edhe komasacioni delë në listë të pritjes, edhe prona shtetërore delë në listë të pritjes, që do të thotë se ky është një fakt shumë i mirë për legalizim. Deri në vitin 2004, ka qenë pa pagesë, është një ligj me procedura shumë të thjeshta dhe vetëm një elaborat duhet të bëhet përmes gjeodetit të licencuar. Pastaj një euro është m² dhe prapë i mbetet mundësia Kuvendit me ulë në 50 centë, ose pa pagesë sepse ligji e lejon. Ne kemi bërë një legalizimi bukur të madh dhe jemi në fazën e kategorisë së dytë.

Lulzim Sadiku –Pyeti çfarë zone është fshati Hamidi.

Arben Berisha – Përgjegjet se fshati Hamidi, është zonë me interes nacional dhe me ligjin e ri e kemi paraparë që edhe në Hamidi, me pasë zhvillim deri në ardhjen e KEK-ut.

Lulzim Sadiku – Faleminderit për informim, unë të respektoj se e ke marrë me fuqinë e botës mënyrën më besnike,sa herë që ke konkurue. Vërtetë e ke marrë besimin e qytetarëve. Të respektoj si kuadër shumë i mirë i Komunës tonë, edhe në Arsim e shumë e shumë të tjera. Mirëpo, realisht dhe shoqërisht kisha me të lutë pasi që keni dhënë dorëheqje prej ombrellës të AAK-së, si këshilltar komunal, që mos me qenë më në AAK, është e ndershme që me dhënë edhe dorëheqje komplet sepse jeni ardhë prej asaj ombrelle. Nëse, ke ardhë prej një shtëpie që në fakt e ke marrë besimin, të kisha lute me dhënë dorëheqje sepse është miqësore dhe njerëzore me dhënë dorëheqje edhe nga këshilltarët.

Enver Gashi – Është shumë e vërtetë, që në ombrellën e AAK-së, ne e kemi marrë besimin dhe nuk e kemi marrë si parti, por si individë.

Është e drejtë e secilit anëtarë të Kuvendit, që ta përcaktoj veten se ku është. Ne si grup 6, plus 3 të LDK-së, që na janë bashkangjitur jemi marrë vesh që prej sotit të vazhdojmë rrugëtimin si anëtarë të Kuvendit, por pa asnjë emër të subjektit ekzistues, jemi të pavarur dhe çka do të sjellë e ardhja do ta shohim. Ne do të veprojmë si grup dhe fatbardhësishtë gjithë jemi unik dhe këtu, asgjë nuk ka të keqe. Unë me dhënë dorëheqje sot, japë dorëheqje 325 vota, që i kam prej popullatës, e jo prej partisë.

Hysni Mjeku - Meqë, u dha informacion nga ish subjekti politik tash AAK-ja, vërtetë për neve këshilltarëve komunal, kjo është irelevante, nuk është ku me ditë e rëndësishme sepse njerëzit mundem me notue herë në të djathtë, e herë në të majtë, herë drejtë Mirëpo, më i mirë është një ujë i turbullt që rrjedhë se sa një ujë që është i kthjellët dhe qëndron në një vend. Prandaj, për ne si parti politike, si PDK, është një informacion i mirë sepse vërtetë kam dëgjuar shumë informacione, se Aleanca po shkon në Vetëvendosje, jo po shkon në Iniciativë të re, po flas në bazë të informacioneve. Mirëpo, mbi të gjitha unë e falenderoj Kryetarin e grupit parlamentar të Aleancës, tashmë si të pavarur, ju uroj shëndet së pari dhe rrugëtim të drejtë. Besoj se kjo është edhe një pasuri e Obiliqit, se edhe një subjekt i ri po na bashkangjitet, ndoshta na bashkangjiten dhe lindin edhe shumë subjekte tjera, sepse disa parti zhduken, e disa lindin. Mbi të gjitha, unë e falenderoj si një informacion jashtëzakonisht i mirë për neve këshilltarët, që mos të marrim informacione nga çdo kush, që nuk kanë as interes. Edhe njëherë urime dhe le të mbetet ajo si një kujtim për Obiliqin, që e kemi pasë një subjekt politik që i ka fitue zgjedhjet, i ka fitue kandidati kuptohet me asambleistë. Nga kjo po shihet se vjeshta e ardhshme do të jetë e nxehtë pluraliste dhe unë besoj se vërtetë ka me qenë një betejë jashtëzakonisht e ashpër demokratike dhe kush fiton ia paftë hajrin.

Kryesuesi – Të nderuar, anëtarë të Kuvendit kjo foltore e imja kurrë nuk është shfrytëzuar në asnjë moment si Aleancë, po është shfrytëzuar si anëtar i Kuvendit dhe e kam respektuar qëndrimin e të gjithëve, si të zgjedhur të popullit.

Mbledhja përfundoi në ora 13:15'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri